



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

Në mbështetje të nenit 68 par 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 12 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

FTOHEN, të gjitha klubet sportive që janë aktive dhe të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Lipjanit, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për ndarje të subvencioneve nga Komuna për vitin 2018.

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë :

1. Çertifikata e regjistrimit,
2. Çertifikata e numrit fiskal,
3. Projekt propozimi,
4. Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së,
5. Deklarata e përshtatshëmërisë, pranueshmërisë,
6. Konfirmimi bankar (xhirollogaria klubit),
7. Plani financiar,
8. Dorëzimi i të dhënave për personelin kyq (duke përshtatur detyrat dhe CV-e tyre)

Komuna e Lipjanit do të subvencionoj klubet sportive në këto fusha:

1. Pagesën e regjistrimit të klubit në federatën përkatëse,
2. Pagesën e kootizimit,
3. Pagesën e referimit të ndeshjeve zyrtare të organizuara nga federata,
4. Pagesën e transportit për ndeshje zyrtare,
5. Pagesëne ushqimit të lojtarëve dhe stafit të klubit për ndeshjet zyrtare,

6. Rekuizita sportive,

Aplikantët duhet të plotësojnë deklaratën me shkrim me të cilën garantojnë që:

- I kanë kryer të gjitha obligimet nga mbështetja financiare , nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit,
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siq parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3,

Aplikacionet e pakompletuara të paprecizuara, të panënshkrura nuk do të shqyrtohen.

Gjatë kohës kur kjo thirrje publike është e hapur , klubet sportive e interesuara mund të kërkojnë sqarime përmes postës dhe informacione shtesë përkitazi me thirrjen , por të paktën tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes,

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarfë të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e gjithë dokumentacionit original të kërkuar.

Aplikuesit mund ti dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në Eëbfaqen e Komunës.

Nr. 1-660-16290
Lipjan më 15.03.2018

Kryetari i Komunes së Lipjanit
z. Imri Ahmeti

